



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

KRYETARI

PROJEKTIVENDIM

Nr. 20236, datë 09.12.2021

Për

Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2023-2025 dhe të Buxhetit të vitit 2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore”; Kryetari i Bashkisë i paraqet P/Kalendarin e Përgatitjes së PBA-së 2023-2025, Këshillit të Bashkisë;

Për të vendosur :

I.Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit të vitit 2023, si më poshtë;

Nr	Përshkrimi i Veprimatrisë së Punës	Afati	I ngarkuar për zbatim
1	Përgatitja dhe dërgimi në këshill për miratim të Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2023-2025.	Deri me datë 08.12.2021	Kryetari i Bashkisë Dr.Financë & Buxh.
2	Miratimi i Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.	Deri me datë 25.12.2021	Këshilli i Bashkisë
3	Përgatitja dhe paraqitja në këshill të Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimit Afatmesëm të të ardhurave për dy vitet e para të vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme. Në raport duhet të përfshihen; -metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave; -analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimet e tyre. -analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.	Deri me datë 31.01.2022	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera
4	Përgatitja dhe paraqitja në këshill për miratim i prioriteteve dhe projekteve për investime, si dhe kostot e tyre përkatëse. Qëllimet, objektivat dhe politikat sipas programeve, duke u adresuar edhe në respektimin e të ligjit “Për barazinë gjinore”.	Deri me datë 10.02.2022	Dr. Integritimit European, Dr. Planifikimit Urban, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera
5	Miratimi i Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimeve afatmesme të të ardhurave, prioriteteve të investimeve për të tre vitet e ardhshme 2023-2025.	Deri me datë 20.02.2022	Këshilli i Bashkisë

6	Përgatitja dhe paraqitja në këshillin e bashkisë të taveve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të PBA-së 2023-2025 në nivel programi.	Deri me datë 01.03.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
7	Miratimi i taveve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2023-2025 në nivel programi	Deri me datë 15.03.2022	Këshilli i Bashkisë
8	Hartimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e PBA-së 2023-2025, i cili duhet të përmbajë; -përcaktimin e programeve buxhetore dhe EMP përkatëse; -tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet, të miratuar nga këshilli i bashkisë; -afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve (faza I-rë)	Deri me datë 20.03.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
9	Miratimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e PBA-së 2023-2025 dhe të Buxhetit të vitit 2023.	Deri me datë 20.03.2022	Kryetari i Bashkisë
10	Dërgimi i udhëzimit, manualit shpjegues, modelin e matricës, dhe kërkesave për plotësim nga EMP-ve (drejtoritë)	Deri me datë 22.03.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
11	Plotësimi i matricave, fish/projekteve dhe paraqitja e kërkesave buxhetore sipas programeve nga drejtuesit e EMP, dhe dorëzimi i tyre në Drejtorinë e Financës & Buxhetit me shkresë zyrtare dhe në mënyrë elektronike.	Deri me datë 05.05.2022	Drejtesit e EMP (gjithë drejtoritë)
12	Zhvillimi i dëgjësive publike dhe konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit, lidhur me nivelin e taksave, tarifave, dhe prioritetet e investimeve për tre vitet e ardhshme	Deri me datë 05-20.05.2022	Kryetari i Bashkisë G.M.S-ja
13	Përgatitja dhe paraqitja për vlerësim dhe miratim nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i PBA-së dhe kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtuesit e programeve (EMP)	Deri me datë 25.05.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit GMS-ja
14	Dërgimi me shkrim dhe rrugë elektronike të projektdokumentit të PBA 2023-2025 në Ministrinë e Financës & Ekonomisë	Deri me datë 01.06.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
15	Paraqitja për miratim në këshillin e bashkisë të projektdokumentit të PBA-së 2023-2025, të miratuar nga GMS-ja, së bashku me raportin e vlerësimit të dërguar nga MFE.	Deri me datë 15.06.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
16	Shqyrtimi dhe miratimi i projektdokumentit të PBA-së, faza e parë nga ana e këshillit të bashkisë	Deri me datë 30.06.2022	Këshilli i Bashkisë
17	Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së të miratuar nga këshilli bashkiak.	Deri me datë 05.07.2022	Dr.Financës&Buxh.
18	Përgatitja dhe paraqitja në këshillin e bashkisë për miratim të taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së për tre vitet e ardhshme në nivel programi.	Deri me datë 15.07.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
19	Shqyrtimi dhe miratimi i taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Deri me datë 20.07.2022	Këshilli i Bashkisë
20	Hartimi i udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit, i cili përmban: -tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi; -afatet e përgatitjes së kërkesave buxhetore; -udhëzimi i miratuar nga kryetari i bashkisë, ju dërgohet gjithë drejtuesve EMP-it (drejtorive).	Deri me datë 25.07.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
21	Pas finalizimit të projektdokumentit të parë të rishikuar, e të publikuar, të organizohen dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit. Në këto takime duhet të mbahen procesverbale, të bëhen regjistrime filmike, të cilat do të bëhen pjesë e dokumentit të PBA-së.	Gjatë muajit Gusht 2022	Kryetari i Bashkisë G.M.S-ja Këshilli i Bashkisë
22	Përgatitja dhe paraqitja për miratim në këshill të dokumentit të rishikuar të PBA-së.	Deri me datë 05.09.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe GMS-ja
23	Miratimi nga këshilli bashkiak i dokumentit të rishikuar të PBA-së 2023-2025.	Deri me datë 15.09.2022	Këshilli i Bashkisë

24	Dërgimi në Ministrinë e Financës & Ekonomisë të dokumentit të PBA-së së rishikuar, të miratuar nga këshilli, shoqëruar me një informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga MFE në fazën e parë.	Deri me datë 15.09.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
25	Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga MFE, të bëhet përgatitja e projektit të PBA-së 2023-2025 dhe projektbuxhetit për vitin 2023. Miratimi nga GMS-ja.	Deri me datë 25.11.2022	Drejtoria e Financës Drejtuesit e EMP-it dhe GMS-ja
26	Projektdokumenti i PBA-së 2023-2025 dhe projektbuxheti për vitin 2023 të paraqitet për miratim nga këshilli i bashkisë	Brenda datës 30.11.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, GMS-ja
27	Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së 2023-2025 dhe projektbuxhetit të vitit 2023.	Deri me datë 25.12.2022	Këshilli i Bashkisë
28	Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së dhe buxhetit të vitit 2022, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij.	Deri me datë 31.12.2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

II.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.

III.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Pjerin Ndreu

